

Me qëllim të nxjerrjes në pah të krimeve ndaj grave, të parandalimit të heshtjes së mëtejshme, harresës dhe mosndëshkimit të krimeve, modifikimit të mëvonshëm (apo revizionit të mëvonshëm) të historisë, si dhe të vendosjes të qasjes së grave në drejtësi dhe regjistrimit të përhershëm të dëshmive mbi krimet dhe dhunën e kryer ndaj grave në shtetet trashëgimtare të RSFJ-së pas vitit 1990, themelohet Gjygi i Grave – Qasja Feministe në Drejtësi.

Duke marrë parasysh se nuk ekzistojnë bazat për rregullimin e procedurës para kësaj Gjykate, as për çështjet tjera të rëndësishme për punën e kësaj Gjygji, nxirren këto:

RREGULLA TË GJYGJIT TË GRAVE

Rregulli 1

Gjygi i Grave i dëgjon dëshmitë e grave mbi krimet dhe dhunën e kryer ndaj tyre.

Rregulli 2

Ky Gjygj nuk vërteton përgjegjësinë penale të individëve për krimet e luftës dhe dhunën e kryer ndaj grave, as përgjegjësinë për kompensimin e dëmit.

Rregulli 3

Dëshmitë e grave kanë të bëjnë veçanërisht me: dhunën në luftë, dhunën në bazë etnike, dhunën militariste, dhunën në bazë gjinore dhe dhunën ekonomike (1).

Rregulli 4

Dëshmitaret dëshmojnë jo vetëm për krimet dhe dhunën e kryer ndaj tyre në kohën e luftës, por edhe për ato pasojat e të cilave janë të vazhdueshme, si dhe për krimet e kryera pas luftës, nën ndikimin e dhunës së pasluftës, dhunës ekonomike, militariste, religjioze dhe dhunës tjetër shtetërore, shoqërore dhe familjare. Dëshmitaret dëshmojnë edhe për rezistencën individuale dhe/ose të organizuar të grave ndaj të gjitha formave të dhunës.

Rregulli 5

Dëshmitaret, sipas rregullit, dëshmojnë publikisht dhe çdoherë personalisht. Gjygi i Grave i dëgjon pa parashtruar pyetje ose pa ndërprerje, dhe mund të parashtrrojë pyetje vetëm me qëllim të sqarimit të kohës apo vendit të ngjarjes.

Rregulli 6

Përveç dëshmitareve, Gjygin e Grave e dëgjojnë edhe bashkëpunëtorët të cilat i ndihmojnë Gjygit të Grave që ta kuptojë kornizën politike, kohore dhe hapësinore të kryerjes së krimeve dhe ndërmarrjes së akteve të dhunës (konteksti si bazë e dëshmive personale).

Rregulli 7

Dëshmitë personale të lidhura me kontekstin regjistrohen në formë akustike dhe optike, dhe pastaj në formë të shkruar dhe e përbëjnë Librin e Dëshmive të Grave. Për botimin dhe publikimin e Librit të Dëshmive të Grave kujdeset Gjygi i Grave.

Rregulli 8

Në bazë të tregimeve të dëshmitareve dhe bashkëpunëtoreve, Gjygi i Grave shqipton dënimin publik për përgjegjësinë politike dhe qytetare të kryerësve, ua dërgon kërkesat dhe rekomandimet institucioneve të rendit juridik dhe monitoron mënyrën e veprimit të këtyre institucioneve sipas kërkesave dhe rekomandimeve.

Rregulli 9

Gjygi i Grave është iniciativë regjionale e shoqërisë civile në shtetet trashëgimtare të RSF të Jugosllavisë dhe nuk do të institucionalizohet, as nuk do t'i bashkëngjitet ndonjë institucioni shtetëror.

Rregulli 10

Dëshmitaret, në emër të Gjygi i Grave, i dëgjon Kolegji Gjyqësor Ndërkombëtar. Dëshmitareve dhe Kolegjit Gjyqësor Ndërkombëtar iu ndihmojnë bashkëpunëtorët e Gjygjit të Grave të cilat, duke filluar nga dëshmitë personale të grave, analizojnë kontekstin më të gjerë social, ekonomik, politik dhe gjinor në të cilin ndodhin padrejtësitë dhe dhuna.

Rregulli 11

Organizatat joqeveritare të cilat e përbëjnë Këshillin Organizativ (2) për Gjygjin e Grave do t'i emërojnë personat që e meritojnë besimin për anëtarët e Kolegjit Gjyqësor Ndërkombëtar. Këto anëtare do t'i dëgjojnë dëshmitë me vëmendje dhe do t'i regjistrojnë ato, dhe në emër të solidaritetit me gratë ndaj të cilave janë kryer krimet dhe dhuna, do të vërtetojnë përgjegjësinë politike dhe qytetare të kryerësve dhe do t'ju dërgojnë kërkesa dhe rekomandime institucioneve të rendit juridik, si dhe do të monitorojnë përmbushjen e tyre.

Rregulli 12

Detyra e anëtareve të Kolegjit Gjyqësor Ndërkombëtar është dëgjimi publik, në vend të marrjes së dëshmimeve, përkrahja aktive, solidarë për dëshmitaret, në vend të gjykimit (shqiptimit të aktgjykimeve), regjistrimi besnik i dëshmimeve, në vend të përpilimit të procesverbaleve, shmangia e burokratizimit të procedurës së dëgjimit të dëshmimeve dhe kujdesi për përmbushjen e kërkesave dhe rekomandimeve të cilat i publikon dhe i dërgon.

(1) Krimet e luftës, siç janë vrasjet, spastrimi etnik, dëbimi i detyruar, krimet seksuale (përdhunimi, shtatzënia e detyruar, mbajtja në pozitë të skllavërisë apo të nënshtrimit me qëllim të shfrytëzimit seksual), tortura, puna e detyruar, shtypja, dhuna dhe eksploatimi ekonomik, si dhe diskriminimi me rastin e punësimit, duke përfshirë politikën ekonomike diskriminuese, dhunën e cila është produkt i keqpërdorimit të traditës, religjionit apo zakoneve, dhunën militariste (lufta kundër popullatës civile), mobilizimi i detyrueshëm, pasojat e mobilizimeve të detyrueshme për gratë (shëndetësore, psikologjike, emocionale, ekonomike, sociale, politike), militarizimi i jetës shoqërore – (propaganda luftënxitëse përmes medie, sistemit arsimor), krijimi i armiqve dhe frikës, persekutimi, represioni politik, mostoleranca ndaj të tjerëve dhe ndaj personave të ndryshëm (në pikëpamje etnike, fetare, politiko-kulturore, seksuale), etj.

(2) Lëvizja e Nënave të Enklavave Srebrenica dhe Zhepa; Fondacioni CURE, Sarajevë; Qendra për Edukim Paqësor të Grave - Anima, Kotor; Qendra për Studime të Grave dhe Qendra për Gratë Viktimat e Luftës, Zagreb; Rrjeti i Grave të Kosovës; Këshilli për Barazi Gjinore, Shkup; Lobi i Grave të Sllovenisë; Qendra për Studimet e Grave dhe Gratë në të Zeza, Beograd.